

Platforma Civikos me mbështetje të DEMOS kanë formuar grupin e Auditimit Social në Pejë.

Projekti	Rregullimi i Parkut Karagaq
Çmimi total i punëve në kontratë	EUR 69,879.24
Statusi i kontratës	E pa përfunduar



Grupi i Auditimit Social në Pejë ka 20 anëtarë.

GJETJET KRYESORE



Ulëset e metalit të vendosura në Parkun Karagaq nuk ofrojnë komoditet.



Mungon ndriçimi në Park pas orës 23:00, duke mos ofruar siguri të mjaftueshme për qytetarët.



Parku nuk ofron infrastrukturë të përshtatshme, si pjerrina për persona që lëvizin me karrocë.



Ka ende mbetje inerte të pa pastruara tek pjesa e liqenit.



Parku nuk është i mbrojtur pasi dëmtohet shpesh (mungesa e rojeve).

REKOMANDIMET

Të shikohet mundësia e modifikimit të ulëseve të hekurit, për të bërë këto më komode për qytetarët për të gjitha stinët.

Të mbahet ndriçimi në park edhe pas orës 23:00 duke e rritur sigurinë e kalimtarëve.

Komuna t'i përfshijë qytetarët më aktivisht në dizajnimin e projekteve të ngjashme.

Të vendosen kamera në park për të rritur mbikçyrjen për dëmtimet eventuale.

Të shtohet ndriçimi edhe në pjesë tjera të parkut dhe të mbillen më shumë drunjë.